



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Eugert Sina**, më datën **14.06.2024**, Nr. Regj. Them. 368, ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Shuarjen e masës së sigurimit personal dhënë me vendimin nr.24 akti, datë 18.03.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr.19(87-2024-132) datë 16.05.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, me vendimin Nr. **368**, datë 18.06.2024 vendosi:
 1. Pranimin e pjesërisht të kërkesës së kërkuesit **Eugert Sina**.
 2. Konstatimin e humbjes së fuqisë së masës së sigurimit personal me karakter ndalues “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik” parashikuar nga neni 242 i Kodit të Proçedurës Peanle, caktuar ndaj personit nën hetim **Eugert Sina**, me vendimin Nr.62-2024-1217, datë 05.03.2024, të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Fier, miratuar me vendimin nr.24, datë 18.03.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr.19(87-2024-132) datë 16.05.2024 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
 3. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 (pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 18.06.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar